



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA FUSHË-ARRËZ

ZYRA E TATIM TAKSAVE



PAKETA FISKALE

2025

“Për një qeverisje vendore që synon të rrisë kapacitetet fiskale dhe administrative për realizimin e funksioneve në përgjegjësinë e saj

A. Mbi Bashkinë Fushë-Arrëz

Konteksti i ri Bashkisë Fushë-Arrëz paraqet jo vetëm zgjerim gjeografik të kufijve administrativë, por edhe shumëllojshmëri të territorit. Bashkia mbulon tashmë territore, që shtrihen nga Fierza (HEC-i) e përfundojnë në Fushë-Arrëz, duke përfshirë ekosisteme e tipologji të ndryshme terrenesh. Secili nga këto territore ka ndërthurjen e vet të traditave, burimeve natyrore, burimeve ekonomike e cilësive infrastrukturore. Bazuar në politikat zhvillimore të territorit të Bashkisë së Fushë-Arrëz *veprimet tona duhet t'i japin vlerë zhvillimit të qëndrueshëm, mbrojtjes së burimeve natyrore dhe traditave tona kulturore. Ndaj çështja kryesore është gjetja e mundësive që të kthejmë këtë shumëllojshmëri në avantazh konkurrues dhe çdo territor të kontribuojë në mirëqënien e Bashkisë.*

Për të krijuar këtë mjedis, ne do fokusojmë punën në përdorimin efektiv të burimeve njerëzore, fizike dhe financiare.

Sipas Ligjit nr 115/ 2014, “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, *Njësi Administrative Fushë-Arrëz* quhet zona urbane që zinte Bashkia Fushë-Arrëz përpara ndarjes së re territoriale. Po sipas këtij ligji, Njësi Administrative të tjera, quhen zonat sipas Tabelës, të cilat ishin komuna përpara ndarjes së re territoriale.

Tabelë 1. Ndarja e Njësive Administrative të Bashkisë Fushë-Arrëz.

Njësi Administrative / Fshatra

Nr.	Njësia Administrative	Fshatra
1	Fushë-Arrëz	Qyteti Fushë-Arrëz, Fshati Lumardh, Micoj dhe Fshat Fushë-Arrëz
2	Qafë-Mali	Fshatrat Kryezi, Qafë-Mali, Lumardh, Srricë, Armiraj , Lajthizë, Tuç, Orosh
3	Blerim	Fshatrat Dardhë, Qebik, Xath, Truen, Flet, Kolumri, Blerim
4	Fierzë	Fshatrat Fierzë, Bugjon, Apripë Guri, Mzi, Arst, Kokdodë, Miliska, Porav
5	Iballë	Fshatrat Iballë, Lëvoshë, Sapaç, Mertur, Berishe e Siperme, Berishe e vogël
		Shopël, Berishe Vendi.

A.1 Procesi i Hartimit të Paketës fiskale

Pas bashkimit të menjëhershëm të 5 (pesë) njësive të qeverisjes vendore, Bashkia e Fushë-Arrëzit u ballafaqua me nevojën e hartimit të një pakete fiskale të integruar dhe të aplikueshme në të gjithë territorin.

Për hartimin e paketës fiskale janë angazhuar drejtuesit dhe specialistët në Bashkinë Fushë-Arrëz:

- Zyra e Tatim Taksave,
- Zyra e Financës,
- Zyra e Shërbimeve Publike
- Zyra e Studimeve, Planifikimit, Koordinimit dhe Monitorimit të Investimeve,
- Zyra e Kontrollit dhe Planifikimit të Territorit,
- Zyra e Shërbimeve Sociale
- Zyra e Kulturës, Arsimit, Rinisë dhe Sportit,
- Zyra e Mjedisit, Pyjeve dhe Menaxhimit të Ujërave,
- Zyra e Burimeve Njerëzore
- Zyra Juridike dhe Prokurimeve,
- Administratorët e Njësive Administrative,

Procesi i hartimit të paketës fiskale të integruar

Ngritja e grupit të punës për hartimin e paketës

fiskale të integruar

Përcaktimi i bazës ligjore dhe prioritetëve strategjike të zhvillimi

Konsultimi i propozimeve të paketës fiskale me banorët në çdo njësi administrative dhe grupet e interesit, bizneset etj.

Hartimi i draftit të paketës fiskale dhe miratimi nga këshilli i bashkisë

Publikimi i paketës fiskale

Konsultimi me qytetarë dhe grupe interesi

Në hartimin e paketës fiskale të Bashkisë së Fushë-Arrëz janë përfshirë përfaqësues të biznesit të madh (juridik) dhe të vogël (fizik), banorë të njësive administrative, përfaqësues të komunitetit sipas interesit dhe këshilltarë.

Gjatë muajit Dhjetor 2023 propozimet për taksat dhe tarifatat vendore janë diskutuar me përfaqësues të komuniteteve të njësive administrative Fierzë, Iballë, Qafë-Mali dhe Blerim.

Me 22 Nëntor 2021 është organizuar tryezë konsultative me përfaqësues të komunitetit të njësive administrative të qytetit të Fushë-Arrëzit. Gjatë këtyre takimeve ka patur pyetje, diskutime dhe propozime për përmirësim.

A.2 Çfarë prezanton paketa fiskale?

Vizioni ynë, për një territor bashkiak të integruar, parashikon planifikim dhe investime që krijojnë mundësi për një zhvillim të qëndrueshëm të balancuar për të gjithë territorin, duke mbrojtur burimet natyrore. Kjo qasje bazohet në përforcimin e identitetit të secilës zone të Bashkisë, duke patur parasysh burimet natyrore, profilin ekonomik dhe produktet, shtrirjen e shërbimeve dhe traditën, me synimin e përhershëm të rritjes së nivelit të jetesës. Mirëadministrimi i burimeve financiare nëpërmjet planifikimit sa më real të paketës fiskale si dhe zbatimi me rigorozitet i rregulloreve dhe urdhëresave përbën moton e punës tonë. Planifikimin e kemi mbështetur në shpërndarjen sa më të drejtë të ngarkesës tatimore duke bërë përcaktimin i nivelit të tarifës sipas llojit të aktivitetit, sipas vendndodhjes gjeografike, duke lehtësuar bizneset në zonat më pak të zhvilluara. Ne synojmë që të kemi në dorë një mekanizëm i cili na ndihmon për të arritur objektivat në realizimin e prioritetëve të identifikuar në planet tona strategjike më afatgjata. Përfshirja e qytetarëve, grupeve të interesit, komunitetit në përgjithësi, mbetet pikë kyçe e suksesit jo vetëm në hartimin e kësaj pakete por sidomos për zbatimin e saj.

Nga analiza e ecursisë së realizimit të të ardhurave të deritanishme rezulton se ka burime akoma të pashfrytëzuara në kapacitetet optimale. Kjo vërehet pothuaj në të gjitha njësitë administrative.

Bazuar në të gjitha sa më sipër, ju paraqesim propozimet tona për sistemin e ri të taksave dhe tarifave që ne duam të zbatojmë për periudhën në vazhdim, duke qenë në linjë dhe në zbatim të prioritetëve të strategjisë së Bashkisë së Fushë-Arrëz. Propozimet janë në përputhje me ndryshimet ligjore të ndodhura. Ato konsistojnë në përmirësime teknike dhe proceduriale, duke patur parasysh që është hera e parë e përgatitjes së një pakete fiskale të integruar, gjithëpërfshirëse dhe afatgjatë.

Në mënyrë të përmbledhur kjo paketë fiskale synon:

Hartimin e një pakete fiskale të integruar.

Rishikimin e kornizës ligjore me qëllim përcaktimin e saktë të taksave, tarifave dhe çdo pagese tjetër që ndikon në buxhetet vendore dhe për të cilat njësia vendore duhet të arkëtojë të ardhura.

Saktësimin e procedurave, afateve, aktorëve, veprimeve, përgjegjësi për çdo taksë dhe tarifë, pjesë e kësaj pakete fiskale. Përcaktimi i saktë i të gjithë elementëve të lidhur me menaxhimin do të pasurojë akoma më tej dhe do të vendosë një bazë të fortë për ndërtimin e një sistemi fiskal eficient dhe transparent.

Përcaktimin e qartë dhe ndarjen në seksione të taksave nga tarifat. Çdo taksë dhe tarifë do të detajohet duke patur në konsideratë elementët:

- Taksim i drejtë;
- Tarifim mbështetur në kosto;
- Klasifikim i biznesit, qarkullim vjetor, lloji i aktivitetit;
- Qartësimi dhe përcaktimi i taksave apo tarifave që aplikohen për kategorinë e familjeve nisur nga lloji, vendndodhja etj;
- Analiza e taksave që aplikohen për territorin që mbulon njësia (mbështetur në legjislacionin në fuqi), përcaktimi dhe detajimi në kategori, unifikimi i kategorive për të gjitha taksat, përcaktimi i bazës së taksueshme dhe aplikimi i kufijve që përcakton ligji;
- Rikategorizimi dhe detajimi i taksave;
- Analiza e tarifave që aplikohen për territorin që mbulon njësia (mbështetur në legjislacionin në fuqi), përcaktimi dhe detajimi në kategori, unifikimi i kategorive për të gjitha tarifat, përcaktimi i nivelit të tarifave mbështetur në koston e shërbimit për të cilin vendosen;
- Aplikimi i incentivave apo lehtësirave fiskale për grupe të caktuara taksapaguesish në nevojë, siç parashikon ligji.

A.3 Kuadri ligjor dhe nënligjor

Ligji nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, përbën ligjin bazë për reformat e decentralizimit të pushtetit vendor dhe përcakton rregullat për ushtrimin e të drejtave dhe detyrave të njësive të qeverisjes vendore në drejtim të krijimit të taksave vendore, mbledhjen dhe administrimin e tyre.

Bazuar në Ligjin Ligji nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe Ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar, në të ardhurat vendore përfshihen kryesisht:

- Tatimi i thjeshtuar mbi BV;

- Taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja;
- Taksa e pasurisë;
- Taksa për transferimin e pasurisë së patundshme;
- Taksa për automjetet/mjetet e përdorura;
- Taksa e zënies së hapësirave publike;
- Taksa e tabelës/reklamat;
- Taksa të përkohshme;
- Tarifa për shërbime.

Më poshtë në mënyrë të përmbledhur jepet legjislacioni fiskal vendor, i cili është konsultuar për të hartuar këtë paketë fiskale.

Ligje

- Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 *“Për sistemin e taksave vendore”*, ndryshuar me Ligjin nr. 9745 datë 28.05.07; ndryshuar me Ligjin nr. 9764, datë 09.07.2007; ndryshuar me Ligjin nr. 9931, datë 09.06.2008; ndryshuar me Ligjin nr. 10 073, datë 9.2.2009; ndryshuar me Ligjin nr. 10117 dt. 23.4.2009; ndryshuar me Ligjin nr. 10146 dt. 28.9.2009; ndryshuar me Ligjin nr. 10354, datë 18.11.2010; ndryshuar me Ligjin nr. 10457, datë 21.07.2011; ndryshuar me Ligjin nr. 106/2013, datë 28.3.2013; ndryshuar me Ligjin nr. 181/2013, datë 28.12.2013; ndryshuar me Ligjin nr. 85/2014, datë 17.07.2014; ndryshuar me Ligjin nr. 181/2013, dt. 28.12.2013; ndryshuar me Ligjin nr. 142/2015, datë 17.12.2015, I ndryshuar me ligjin 95/2018.
- Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 *“Për vetëqeverisjen vendore”*.
- Ligji nr. 8438 datë 28.12.1998, *“Për tatimin mbi të ardhurat”*, i ndryshuar me Ligjin nr. 9483, datë 16.2.2006; ndryshuar me Ligj nr. 9632, datë 30.10.2006; ndryshuar me Ligjin nr. 9716 datë 16.04.2007; ndryshuar me Ligjin nr. 9735 datë 17.05.2007; ndryshuar me ligj nr. 9766 datë 09.07.2007; ndryshuar me Ligjin nr. 9804 datë 13.09.2007; ndryshuar me Ligjin nr. 9844 datë 17.12.2007; ndryshuar me Ligjin nr. 9943, datë 26.6.2008; ndryshuar me Ligjin nr. 10072, datë 9.2.2009; ndryshuar me Ligjin nr. 10228, datë 4.2.2010; ndryshuar me Ligjin nr. 10343, datë 28.10.2010; ndryshuar me Ligjin nr. 10364, datë 16.12.2010; ndryshuar me Ligjin nr. 20/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me Ligjin nr. 71/2012, datë 28.6.2012; ndryshuar me Ligjin nr. 122/2012, datë 20.12.2012; ndryshuar me Ligjin nr. 107/2013, datë 28.3.2013; ndryshuar me Ligjin nr. 124/2013, datë 25.4.2013; ndryshuar me Ligjin nr. 177/2013, datë 28.12.2013; ndryshuar me Ligjin nr. 32/2014, datë 3.4.2014; ndryshuar me Ligjin nr. 42/2014, datë 24.4.2014; ndryshuar me Ligjin nr. 83/2014, datë 17.07.2014; ndryshuar me Ligjin nr. 156/2014, dt. 27.11.2014.
- Ligji nr. 9723, datë 3.5.2007 *“Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”*.
- Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008, *“Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar.

- Ligji nr. 10081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.
- Ligji nr. 10304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”.
- Ligji nr. 9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar me Ligjin nr. 10 065, datë 29.1.2009; ndryshuar me Ligjin nr. 10 131 dt. 11.5.2009; ndryshuar me Ligjin nr. 10145, datë 28.9.2009; ndryshuar me Ligjin nr. 10280, dt. 20.5.2010; ndryshuar me Ligjin nr. 10458, datë 21.7.2011; ndryshuar me Ligjin nr. 83/2012, datë 13.9.2012; ndryshuar me Ligjin nr. 120/2013, datë 18.04.2013; ndryshuar me Ligjin nr. 178/2013, datë 28.12.2013; ndryshuar me Ligjin nr. 86/2014, datë 17.07.2014; ndryshuar me Ligjin nr. 157/2014, datë 27.11.2014, I ndryshuar me ligjin 93/2018.
- Ligji nr. 93/2015 “Për turizmin”.
- Ligji nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar.
- Ligji nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”.
- Ligji nr. 10 465, datë 29.9.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”.
- Ligji nr. 8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar.nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”.
- Ligji nr. 9693, datë 19.3.2007 “Për fondin kullosor”, i ndryshuar.
- Ligji nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundravajtjet administrative”.
- Ligji nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar me Ligjin nr. 9561, datë 12.6.2006 dhe Ligjin nr. 9797, datë 23.7.2007.
- Ligji nr. 10296, datë 08/07/2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.
- Ligji nr. 10463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar.
- Ligji nr. 152/2015, datë 21.12.2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”.
- Ligji nr.106/2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar”.

Vendime dhe udhëzime

- Vendimi i Këshillit të Ministrave, nr. 783, datë 10.11.2011,” Për procedurat e ndarjes së të ardhurave të taksës vjetore të mjeteve të përdorura me njësitë e qeverisjes vendore”.
- VKM nr. 7, datë 4.01.2012, “Për përcaktimin e procedurave dhe të dokumentacionit të nevojshëm për arkëtimin e taksës së rentës minerare”, i ndryshuar.
- VKM nr. 970, dt. 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”.

- VKM nr. 396, datë 21.6.2006 *“Për kriteret e transferimit dhe të përdorimit të pyjeve nga njësitë e qeverisjes vendore”*.
- VKM nr. 391 datë 21.06.2006 *“Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”*.
- VKM 632 datë 11.06.2009 *“Për tarifat në sektorin e Kullotave”*.
- VKM 559 datë 29.07.2022 *“Përcaktimin E Cmimeve Dhe Tarifave Për Dhënien Në Shfrytëzim/Përdorim Të Fondit Pyjor Kombëtar, Për Veprimtari Ekonomike, Si Dhe Për Prodhimet Drusore Dhe Jodrusore Pyjore”*.
- VKM nr. 54, datë 05.02.2014 *“Për përcaktimin e kriterëve, dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”*, i ndryshuar.
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 992, datë 9.12.2015 *“Për disa ndryshime në vendimin nr. 54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteoze apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”*, të ndryshuar.
- VKM nr. 469, datë 3.6.2015, “Për përcaktimin e vlerës minimale të çmimit të referencave të qirave të ndërtesave për qëllime tatimore”.
- VKM nr. 575, datë 24.6.2015 *“Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”*.
- VKM nr. 1108, datë 30.12.2015 *“Për transferimin, nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit rural dhe Administrimit të ujërave të Bashkitë, të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme e të paluajtshme të Bordeve Rajonale të Kullimit”*.
- VKM 168, datë 27.03.2019. *“Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së takësueshme të pasurisë së paluajtshme “Ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës.*
- VKM Nr.171 date 28.03.2018 *“Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Taksës së Pasurisë”*
- Udhëzim i Ministrit të Financave nr. 1, datë 12.1.2007 *“Për përcaktimin e veprimtarive që trajtohen si veprimtari, tregtare apo shërbimi, ambulante si dhe procedurat e regjistrimit të tyre në organin tatimor”*.
- Udhëzim i Ministrit të Financave **32, datë 31.12.2013**, *“Për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël”*, i ndryshuar.
- Udhëzim i Përbashkët (Ministri i Financave dhe Ministri i Drejtësisë) nr. 655/1, datë 06.02.2007 *“Për Përcaktimin e Uniformitetit të Standardeve Procedurale dhe të Raportimit të Sistemit të taksës Vendore”*.
- Udhëzim i Ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes nr. 6756, datë 3.9.2015 *“Për zbatimin e vendimin të Këshillit të Ministrave nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”*, i ndryshuar.
-

- Udhëzim nr. 30, datë 27.12.2011, “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, i ndryshuar.
- Udhëzuesi i Ministrit për Çështjet Vendore nr. 541/1, date 31.12.2015 “*Udhëzues për zbatimin e VKM nr. 1108 datë. 30.12.2015 “Për transferimin nga MBZHRAU tek bashkitë, të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme”.*
- *Udhëzimi nr.81 date 06.03.2020 per klasifikimin e objekteve sipas rrezikshmerise nga zjarri. Procedurat e shqyrtimit dhe miratimit te projektete te mbrojtjes nga zjarri dhe shpërtimi, si dhe dhenia e certificates se sigurise nga zjarri.*
- *Vendimi nr.607 date 29.07.2020. per tarifat dhe llojet e shërbimeve qe ofrohen nga shërbimi I mbrojtjes nga zjarri dhe shpërtimi.*

B. Paketa Fiskale

Kapitulli 1: Taksat vendore

Ky kapitull trajton taksat vendore në mënyrë nominale duke u nisur nga elementët:

- Lloji, baza e taksueshme, kategorizimet dhe nën kategorizimet, kështet e pagimit, koha e kryerjes së tyre, kushtet lehtësuese, strukturat përgjegjëse për vjeljen e detyrimeve dhe agjentët tatimorë.

1.2 Taksa mbi pasurinë e paluajtshme

Taksës mbi pasurinë e paluajtshme i nënshtrohen të gjithë personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, pronarë apo përdorues të pasurive të mësipërme, në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre pasurive. Bëjnë përjashtim rastet kur në ligj parashikohet ndryshe. Detyrimin për taksën mbi pasurinë e paluajtshme e ka, sipas rastit, pronari ose bashkëpronari, sipas pjesës që zotëron, apo përdoruesi i pasurisë së paluajtshme, për pasuritë që nuk janë të pajisura me dokumente pronësie.

Në taksat mbi pasurinë e paluajtshme përfshihen:

- **Taksa mbi ndërtesat**
- **Taksa mbi tokën bujqësore**
- **Taksa mbi truallin**

Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë (Prone, Tokë Bujqësore, Truall) përdoruesi i pasurisë bën një vetë deklaram të sipërfaqes pranë bashkisë. Bashkia nëpërmjet komisionit të ngritur mund të vlerësojë sipërfaqen e taksueshme.

1.2.1 Taksa mbi Pronën (Ndërtesa)

A. BAZA E TAKSËS

Përcaktimi vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, (në zbatim të nenit 2 të VKM nr. 132/2018):

1.Percaktimi i çmimit vlerësues dhe i sipërfaqes së ndertesës/njesi pronësore mbështetëse në:

1.1 Vetdeklarimi

1.2 Percaktimi i çmimit të vlerësuar dhe sipërfaqes, bazuar në regjistrin e pasurive të paluajtshme të mbajtur nga ZVRPP.

1.3 Përcaktimi i çmimit vlerësues sipas çmimeve mesatare të shitblerjes së ndertesave /njesi pronësore (aneksi 1.VKM 132/2018).

2. Vlera e pasurisë së paluajtshme “ndërtesë”, referuar verifikimeve në terren

2.1 Sipërfaqja e prezumuar.

a) 100 meter katror sipërfaqe për njësi pronësore, ndërtesa për banim.

b) 70 meter katror sipërfaqe për njësi pronësore, për ndërtesat për banim, të privatizuara me ligjin 7652, datë 23.12.1992, për të tjerat, jo për qelime banimi, njesitë e vetëqeverisjes vendore bëjnë verifikimin në terren, për të përcaktuar sipërfaqen dhe për të llogaritur bazën e taksës.

1. Nënndarja zonale/nënzonale brenda territorit të vetëqeverisjes vendore.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të miratojnë nënndarje zonale/nënzonale të territorit, brenda juridiksionit të tyre, për zbatimin e niveleve të shkallës së taksës brenda kufijve plus 30 (tridhjetë) për qind ose minus 30 (tridhjetë) për qind. Këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore, jo më shpesh se një herë në vit, për banesat në njësitë administrative jashtë qytetit përkatës, të cilat iu bashkuan njësive të qeverisjes vendore pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 115/2014, mund të reduktojë çmimin mesatar referues të përcaktuar në aneksin 1, deri në masën minus 35 (tridhjetë e pesë) për qind, krahasuar me çmimin e zonës më të afërt, përjashtuar zonat rezidenciale.

2. Vlera e pasurisë së paluajtshme për ndërtesat e përfunduara në shkëlqim të afatit të lejes së ndërtimit.

- a. Baza e taksës së ndertesës llogaritet në masën 30% të shkallës përcaktuar me ligj, shumëzuar me koston e ndërtimit të parashikuar në lejen e ndërtimit.
- b. Në rastet, kur njësi të ndertesës janë parashikuar për qelime ndryshme përdorimi, vlera e pasurisë paluajtshme për përcaktimin e bazës së taksës llogaritet 30% e shkallës të përcaktuara me ligj, sipas llojit të përdorimit, shumëzuar me koston e ndërtimit për njësi të ndertesës. (detyrimin për të paguar këto taksa e ka zhvilluesi).
- c. **30%** e shkallës së taksës përkatëse për të gjithë sipërfaqen ndërtimore, për të cilën zhvilluesi, është pajisur me leje ndërtimi dhe nuk ka arritur ta përfundojë atë sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.

3. Llogaritja e shumes se takses ndertesë/njësi pronësore.

Baza e llogaritjes se taskses se ndertesës është vlera e ndertesës/njësi pronësore, percaktuar me një nga metodat e parashikuara në VKM nr.132/2018, për efekt të llogaritjes se takses për ndertesën/njësi pronësore, baza e takses shumezohet me shkallën në përqindje të takses miratuar me ligj sipas kategorive të ndertesave si më poshtë:

- 0.05%** për ndertesën /njësi pronësore që përdoret, shfrytëzohet për banim.
- 0.2%** ndertesën/njësi pronësore që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike.
- 30%** e shkallës së takses perkatese, për të gjithë sipërfaqen ndërtimore, për të cilën zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi dhe nuk ka arritur të perfundojë atë, sipas afatit të percaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.

Tabela 2. Taksa mbi ndërtesën, për qëllime banimi referuar aneksit 1 dhe 2, të VKM nr.132 datë 07.03.2018, që do të përdoren për llogaritjen e vlerës së pasurisë sipas Njësisë Administrative

Nr.	Bashkia Fushë-Arrëz	Çmimi Referues lekë m/2
1.	Njësia Administrative Fushë-Arrëz	7.500
2.	Njësia Administrative Qafë-Mali	4.875
3.	Njësia Administrative Blerim	4.875
4.	Njësia Administrative Fierzë	4.875
5.	Njësia Administrative Iballe	4.875

Tabela 2.1. Taksë mbi prone, vlera e taksës për m/2 ndërtesë që përdoren për qëllime banimi e llogaritur sipas metodologjisë së përcaktuar në VKM nr.132 datë 07.03.2018 Aneksi 1 dhe 2.

Shkalla e takses 0.05%

Nr.	Bashkia Fushë-Arrëz	Çmimi referues lekë m/2	Taksa për m/2 sipas VKM	Sipas VKB referohet -30%
1.	Njësia Administrative Fushë-Arrëz	7.500	3.75	2.63
2.	Njësia Administrative Qafë-Mali	4.875	2.44	1.71
3.	Njësia Administrative Blerim	4.875	2.44	1.71
4.	Njësia Administrative Fierzë	4.875	2.44	1.71
5.	Njësia Administrative Iballe	4.875	2.44	1.71

Tabela 2.1.2 Sipas VKM nr 457/2023 Aneksi 2: Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të miratojnë nënndarje zonale/nënzonale të territorit, brenda juridiksionit të tyre, për zbatimin e niveleve të shkallës së taksës brenda kufijve plus 30 (tridhjetë) për qind ose minus 30 (tridhjetë) për qind. Këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore, jo më shpesh se një herë në vit, për banesat në njësitë administrative jashtë qytetit përkatës, të cilat iu bashkuan njësive të qeverisjes vendore pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 115/2014, mund të reduktojë çmimin mesatar referues të përcaktuar në aneksin 1, deri në masën minus 35 (tridhjetë e pesë) për qind, krahasuar me çmimin e zonës më të afërt, përjashtuar zonat rezidenciale.

Shkalla e masës 0.2%

Veprimtari Ekonomike

Njësia Administrative Fushë-Arrëz					
Nr.	Lloji i veprimtarisë	Niveli i çmimit referues	Çmimi referues lekë m/2	Shkalla taksës ne %	Niveli i tasës në lekë m/2
1.	Njësi tregtimi dhe shërbime	150% e çmimit të banesave	11.250	0.2	22.5
2.	Për parkimet e mbuluara dhe bodrumet	70% e çmimit të banesës	5.250	0.2	10.5
3.	Për parkimet e hapura	30% e çmimit të banesave	2.250	0.2	4.5
4.	Për veprimtari industriale	50% e çmimit të banesave	3.750	0.2	7.5
5.	Për veprimtari bujqësore dhe blegtorale	30% e çmimit të banesave	2.250	0.2	4.5

Shkalla e masës 0.2%

Veprimtari Ekonomike

Njësia Administrative Qafë-Mali, Blerim, Fierz, Iballe					
Nr.	Lloji i veprimtarisë	Niveli i çmimit referues	Çmimi referues lekë m/2	Shkalla taksës ne %	Niveli i tasës në lekë m/2
1.	Njësi tregtimi dhe shërbime	150% e çmimit të banesave	7.313	0.2	14.63
2.	Për parkimet e mbuluara dhe bodrumet	70% e çmimit të banesës	3.413	0.2	6.83
3.	Për parkimet e hapura	30% e çmimit të banesave	1.462	0.2	2.93
4.	Për veprimtari industriale	50% e çmimit të banesave	2.437.5	0.2	4.88
5.	Për veprimtari bujqësore dhe blegtorale	30% e çmimit të banesave	1.462	0.2	2.93

**B. Nenkategorizimi specific ndertesash dhe qellimi i perdorimit.
(Referuar nenit 3, VKM nr.132/2018)**

Nenkategorizimi i ndertesave /njesi pronesore qe nuk perdoren per banim, sipas qellimit perdorimit dhe te shfrytzezimit te tyre, sipas aneksit 2 te VKM nr.132/2018 neni 3

Nenkategoria e ndertesave /njesi pronesore, qe perdoren per banim/strehim, jepen si me poshte:

1. Ndertesa, e cila u sherben njerezve per nevoja themelore banimi, duke perfshire shtepite, apartamentet, banesat dhe ndertesat e ngjashme.
2. Garazhet e mbyllura
3. Bodrumet
4. Çdo ndertese tjeter e ngjashme, mbi apo nen toke, qe nuk perdoret apo shfrytezohet per qellime te tjera vec atij te banimit.

C. Natyra e informacionit dhe te dhenave qe perdoret per percaktimin e baze se takses mbi ndertesat dhe informimi i publikut, (referuar VKM nr.132/2018, neni 4)

1. Vetdeklarimi nga taksapaguesi
2. Te dhenat e disponuara nga ZVRPP
3. Te dhenat e Urbanistikes per lejet e dnertimit
4. Te dhenat nga zyra e noterise per transaksionet te shitbljerejes se ndertesave
5. Te dhenat e ALUIZNI-t
6. Te dhenat nga verifikimi ne terren nga vete njesite e veteqeverisjes vendore.
7. Te dhenat nga Regjistri Qendrore te Gjendjes Civile
8. Te dhenat nga OSHEE (Operatori I Shperndarjes se Energjise Elektrike)
9. Te dhenat nga Agjensia e Trajtimit te Pronave per pasuri te trajtuara me vendim te KKKP-se.

D. Çmimet mesatare per m2 sipërfaqe ndertimi per banesat qe nuk sherbejne per ndertim

Tabela 3: Taksa mbi Ndërtesën

Emertimi	Çmimi referues eshte 7500lek/m2 (Nivel ligjor sipas VKM nr 457/2023) Aneksi 1.	Bashkia Fushe- Arrez	Njesite Administrative Qafe-Mali, Blerim, Iballe, Fierze (Nivel ligjor sipas VKM nr 457/2023) Aneksi 2.
Çmimi per m2 sipërfaqe ndertimi per veprimtari tergetimi dhe sherbimi si ndertesa tergetrae ,ku njekoheisht realizohen dhe proçese te perziera prodhim,tergetim,ose/dhe sherbime me pakice	1.5 here me i larte se çmimi sipërfaqes banimi ne qytet	1.5 here me i larte se çmimi sipërfaqes banimi ne qytet	Çmimi per m2 te sipërfaqe ndertese te destinuar per banim minus 35% te Bashkise Fushe -Arrez
Çmimi per m2 sipërfaqe ndertimi per parkim te mbuluar me bodrume eshte 70% e çmimit te sipërfaqeve te apartamenteve te banimit sipas qyteteve	70% e çmimit sipërfaqe banese te apartamentit banese sipas qyteteve	70% e çmimit sipërfaqe banese te apartamentit banese sipas qyteteve	Minus 35% te te Bashkise Fushe-Arrez
Çmimi per m2 sipërfaqe ndertimi per	30% e çmimit te	30% e çmimit te	Minus 35% te te

parkim te hapur eshte 30% e çmimit te siperfaqeve te apartamenteve te banimit sipas qyteteve	siperfaqeve te apartamenteve te banimit sipas qyteteve	siperfaqeve te apartamenteve te banimit sipas qyteteve	Bashkise Fushe-Arrez
Çmimi per m2 siperfaqe ndertimi per veprimtari industrial si: Prodhim ,perpunim ose magazinimin te mallrave industrial duke perfshire fabrikat,depot,magazinat dhe objekte te tjera te ngjashme eshte 50% e çmimit te siperfaqeve te apartamenteve te banimit sipas qyteteve	50% e çmimit te siperfaqeve te apartamenteve te banimit sipas qyteteve	50% e çmimit te siperfaqeve te apartamenteve te banimit sipas qyteteve	Minus 35% te te Bashkise Fushe-Arrez
Çmimi per m2 siperfaqe ndertimi qe perdoren per bujqesi dhe blegtori apo veprimtari mbeshtetese si:grumbullim,magazinim dhe ruajtje te produkteve bujqesore dhe blegtorale eshte 30% e çmimit te siperfaqeve te apartamenteve te banimit te zones perkatese me perjashtim te perpunimit ushqimor	30% e çmimit te siperfaqeve te apartamenteve te banimit sipas zones perkatese me perjashtim te perpunimit ushqimor	30% e çmimit te siperfaqeve te apartamenteve te banimit sipas qyteteve	Minus 35% te te Bashkise Fushe-Arrez
Çmimi per m2 ndertimite destinuar per banim ne Njesite Administrative te cilat u bashkuan njesive te veteqeverisjes vendore pas hyrjes ne fuqi te ligjit nr.115/2014,reduktohet deri ne 35% krahasuar me zonat me te afert,perjashtuar zonat rezidenciale			Minus 35% e çmimit siperfaqeve banimit te apartamenteve te banimit te Bashkise Fushe-Arrez
Per ndertesat e privatizuara me ligjin nr.7652 date 23.12.1992 “Per privatizimin e ndertesave shtetore”,te ndryshuar ,çmimi per m2 eshte 70% e çmimit sipas zonave te tabelës ,vetem ne rastin e shitjes se pare.	Çmimi per m2 eshte 70% e çmimit te zonave te tabelës vetem me shitjen e pare	Çmimi per m2 eshte 70% e çmimit te zonave te tabelës vetem me shitjen e pare	Minus 35% e çmimit siperfaqeve banimit te apartamenteve te banimit te Bashkise Fushe-Arrez
Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimore për ndërtimet e reja regjistruar sipas lejes së përdorimit në ASHK, pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, do të indeksohet me koeficientin 0.2 (zero pikë dy) herë më i lartë se çmimi i sipërfaqes së apartamentit të banimit sipas listës së përcaktuar aneksin 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi, për 5 vitet e para pas regjistrimit të lejes së përdorimit në ASHK.	Çmimi 0.2 % (zero pikë dy) herë më i lartë se çmimi i sipërfaqes së apartamentit të banimit	Çmimi 0.2 % (zero pikë dy) herë më i lartë se çmimi i sipërfaqes së apartamentit të banimit	Minus 35% e çmimit siperfaqeve banimit te apartamenteve te banimit te Bashkise Fushe-Arrez

- **Mënyrat e Pagesës:**

- a. Detyrimi për taksën mbi ndërtesën është vjetor.
- b. Për të gjitha kategoritë ky detyrim do të paguhet me 1 (një) këst.
- c. Afati i pagesës është 20 prill.
- d. Afati i pagesës për detyrimet e lindura pas datës 20 prill është 30 ditë pas lindjes së detyrimit.

- **Agjenti Tatimore**

Agjenti tatimor është Ndermarrja e Ujesjelles Kanalizimeve, dhe Zyra e Tatim-Taksave, Bashkia Fushe-Arrez.

Përfshihen nga Taksa mbi ndërtesat

- a. Pronat e shtetit dhe të njësive të qeverisjes vendore, që përdoren për qëllime jofitimprurëse.
- b. Pasuritë në pronësi të shtetit, të kaluara me VKM, nën administrimin e shoqërive publike shtetërore.
- c. Ndërtesat e banimit, që shfrytëzohen nga qeramarrësit me qera të paliberalizuara
- d. Banesat sociale në pronësi të bashkive
- e. Pasuritë e paluajtshme-ndërtesa, pronë e subjekteve juridike ose fizike, që në bazë të marrëveshjeve me bashkitë përdoren nga këto të fundit si banesa sociale;
- f. Ndërtesat që përdoren nga komunitete fetare, në funksion të veprimtarisë së tyre;
- g. Përfshihen nga pagesa e kësaj takse investimet e kryera për ndërtimin e strukturave akomoduese “Hotel/Resort me pesë yje, status special”, sipas përcaktimit në legjislacionin të fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht “brand name.”
- h. Ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që përfitojnë pension pleqërie ose pension social, që janë me banim në fshat ose në qytet, kur familja përbehet vetëm nga pensionistët;
- i. Ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që trajtohen me ndihmë ekonomike;
- j. Ndërtesat kulturore, nën mbrojtje të përkoshme ose të përhershme, për kohën në të cilën deklarohet mbrojtja, sipas legjislacionit në fuqi për monumentet e kulturës ose trashëgimisë kulturore.

1.2.2 Taksa mbi tokën bujqësore

Përkufizimi: “*tokë bujqësore*” është toka e përcaktuar si e tillë në regjistrin e zyrave të regjistrimit të pasurisë.

Baza e taksës: Është sipërfaqja e tokës bujqësore, në hektar, në pronësi apo në përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e tokës përcaktohet mbi bazën e dokumenteve të pronësisë, formularit nr.6, aktit të pronësisë, certifikatës së regjistrimit të tokës.

Niveli i taksës mbi tokën bujqësore paraqitet si më poshtë:

Tabela 4: Niveli i taksës mbipasurine e paluejtshme Toke

Kategoritë mesatare të tokës bujqësore	Njësia	Niveli i taksës mbi tokën bujqësore		
		Sipas ligjit	NjA Fushë-Arrëz	NjA të tjera
VII – X	lekë/ha/vit	700	700	500

Shënim : Klasifikimi sipas kategorive të tokës bujqësore behet nga strukturat e Ministrisë së Bujqësisë.

Detyrimi per pagese: Detyrimi per taksen mbi pasurine e paluejtshme toke bujqesore eshte vjetor. Niveli I takses caktohet ne leke per hektar. Detyrimi I takses llogoritet si shumezim I nivelit mbi bazen e tatueshme.

1. Përjashtime: Përjashtohen nga pagesa e taksës bujqësore:

- Tokat bujqësore, që mbillen me kultura drufrutore dhe vreshtari për pesë vitet e para nga çasti i mbjelljes.

2. Mënyrat e Pagesës:

- Detyrimi për taksën mbi token është vjetor.
- Për të gjitha kategoritë ky detyrim do të paguhet me 1 (një) kësht.
- Afati i pagesës është 20 prill.
- Afati pagesës për detyrimet e lindura pas datës 20 prill është 30 ditë pas lindjes së detyrimit.

3. Strukturat përgjegjëse për vjeljet e taksës:

- Strukturat e ngarkuara për vjeljen e taksës mbi pasurine toke për të gjitha kategoritë është Zyra e Tatim-Taksave pranë Bashkisë Fushë-Arrëz.
- Për njësitë administrative mbledhja e kësaj takse do të bëhet nga specialisti i ngarkuar në bashkëpunim me Zyra e Tatim-Taksave pranë Bashkisë Fushë-Arrëz.
- Ngarkohet Sektori i Pronave dhe Hartografisë për përcaktimin e sipërfaqes në pronësi sipas personave duke pasqyruar dhe ndryshimet e herëpashershme.
- Klasifikimi sipas kategorive të tokës bujqësore bëhet nga strukturat e MBZHRAU.

1.2.3 Taksa mbi truallin

Përkufizimi: Truall është një sipërfaqe toke, jo-bujqësore, që ndodhet brenda vijës kufizuese të ndërtimit, e përcaktuar nëpërmjet dokumenteve ligjore të planifikimit, e miratuar për të ndërtuar mbi të.

Baza e taksës: Është sipërfaqja e truallit, në metër katror, në pronësi apo përdorim të taksapaguesit.

Niveli i taksës mbi pasurine e paluejtshme truall paraqitet si më poshtë:

Tabela 5: Niveli i taksës mbi truallin

Taksa mbi truallin	Njësia	Niveli i taksës mbi truallin	
		Sipas ligjit	Të gjitha NjA
<i>Për qëllime banimi nga individët</i>	<i>lekë/m²/vit</i>	0.14	0.14
<i>Për qëllime biznesi</i>	<i>lekë/m²/vit</i>	12	12

Strukturat përgjegjëse për vjeljen e taksave të Pasurisë së Palujtshme (Ndërtesës, Tokës Bujqësore dhe Truallit):

1. Detyrimi për pagesë:

- llogaritet nga Zyra e Tatim Taksave për *familjarët* dhe shlyhet në Ndërmarrjen e Ujësjetllës Kanalizime sh.a. Fushë-Arrëz, në cilësinë e agjentit tatimor duke arketuar 100 % te vlerës në Llogarinë e Bashkisë.
- Detyrimi për *biznesin* dhe *institucionet* llogaritet nga Zyra e Tatim Taksave në Bashkinë Fushë-Arrëz, dhe shlyhet pranë çdo banke të nivelit të dytë.

2. Mënyrat e Pagesës:

- a. Detyrimi për taksën mbi truallin është vjetor.
- b. Për të gjitha kategoritë ky detyrim do të paguhet me 1 (një) kësht.

1.3. Taksa e fjetjes në hotel

Përkufizimi: Strukturat akomoduese do të përfshijnë kategoritë si më poshtë: a) “*Bujtinë*”; b) “*Fjetinë*” (Hostel); c) “*Kamping*”; ç) “*Hotel*”; d) “*Motel*”; dh) “*Resort*”; e) “*Qendër kurative*”; ë) “*Fjetje dhe mëngjes*” (B&B).

Secila kategori e strukturave akomoduese klasifikohet me sistem të veçantë, e shoqëruar me shenjat dalluese përkatëse, sipas përcaktimit të mëposhtëm: “Bujtinë” Standard, “Fjetinë” Standard, Komfort; “Kamping” Standard, “Hotel” dy yje, tre yje, katër yje, pesë yje; “Motel” Standard, Komfort, Superior; “Resort” tre yje, katër yje, pesë yje; “Qendër kurative” dy yje, tre yje, katër yje, pesë yje; “Fjetje dhe mëngjes” (B&B) Standard, Komfort, Superior.

Baza e taksës: Është numri i netëve të qëndruara në hotel për person.

Niveli i taksës së fjetjes në hotel paraqitet si më poshtë:

Tabela 6: Taksa e fjetjes në hotel

Taksa e fjetjes në hotel	Njësia	Niveli i taksës së fjetjes në hotel
Hotel 4-5 yje	lekë/natë qëndrimi/për person	105
Bujtinë, fjetinë, motel dhe çdo njësi tjetër akomoduese, sipas përcaktimeve të ligjit për turizmin	lekë/natë qëndrimi/për person	35

1. Detyrimi dhe kështet e pagimit:

- Detyrimi për taksën llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës së vendosur nga bashkia, për natë qëndrimi, me numrin e netëve të qëndrimit në hotel.

2. Mënyrat e Pagesës:

- Detyrimi për taksën i takon klientit që strehohet në hotel, detyrim i cili mbahet nga hoteli për llogari të bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet hoteli. Në faturën e hotelit shënohet çmimi i fjetjes dhe mbi të vlera e taksës.
- Detyrimi derdhet për bashkinë brenda datës 5 të muajit pasardhës nga subjekti përkatës.

3. Strukturat përgjegjëse për vjeljet e taksës:

- Strukturat e ngarkuara për vjeljen e taksës së fjetjes në hotel për të gjitha kategoritë është Zyra e Tatim-Taksave pranë Bashkisë Fushë-Arrëz.

1.4 Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja

Baza e taksës: 1. Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet sipas preventivit, ose vlera në lekë e çmimit të shitjes për metër katror të investimit të ri. Klasifikimi si investim i ri përcaktohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për dhënien e lejes së ndërtimit.

2. Në rastin e ndërtimeve të destinuara për qëllime banimi apo për njësi tregtimi dhe shërbimi, të cilat kryhen nga shoqëri ndërtimi, shkalla e taksës së ndikimit në infrastrukturë është në masën 1 (një) për qind deri 3 (tre) për qind të çmimit të shitjes për metër katror. Në këtë kategori investimesh përfshihen edhe ndërtimet zëvendësuese për qëllime banimi, të kushtëzuara për t'u ndërtuar si shkak i zbatimit të një kontrate koncensionare, e cila prek banesat ekzistuese. Gjithashtu, në këtë kategori përfshihen edhe ndërtimet e destinuara për qendra tregtare apo të biznesit. Baza e taksës është vlera në lekë për metër katror e çmimit të shitjes së ndërtimeve për qëllime banimi apo të njërive të tregtimit dhe shërbimit. Çmimi i shitjes për metër katror bazohet në vlerën referuese të vlerës së tregut, sipas përcaktimeve të nxjerrë me akt nga Këshilli i Ministrave.

